



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade



Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovo Standardisation Agency
Kosovska Agencija za Standardizaciju

Raporti vjetor - AKS 2022

Përmbajtja:

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit
2. Korniza ligjore e AKS
3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)
4. Komitetet Teknike (KT)
5. Standardet e adoptuara
6. Standardet e shfuqizuara
7. Standardet e shitura
8. Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit
9. Notifikimi i standardeve
10. Aktivitetet promovuese të AKS
11. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS
12. Buxheti i AKS
13. Grupet punuese/komisionet
14. Raporte/kërkesa/takime
15. Trajnimet
16. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve të AKS
17. Sfidat e standardizimit kosovar

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), është institucioni i vetëm shtetëror i cili siguron platformë për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur cilësinë dhe sigurinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme i zhvillon/adopton/miraton duke i dhënë prioritet atyre që kërkohen nga palët e interesit, ato që kanë më shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit dhe standardet të cilat janë referencë në direktivat evropiane (të transpozuar në legjislacion vendor). AKS zhvillon Standarde Kosovare për të gjitha palët e interesit dhe punon së bashku me rreth 130 ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët aktivizohen në grupe punuese të Këshillit Profesional të Standardizimit dhe të Komiteteve Teknike.

2. Korniza ligjore e AKS

Baza ligjore e AKS tashmë është e kompletuar dhe e përafuar me *acquis* të BE, megjithatë kërkohet plotësim i vazhdueshëm i kornizës ligjore dhe në këtë kuptim, korniza ligjore e AKS, është plotësuar me:

- a) Draft Rregulloren (ZKM) Nr. XX/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim.
- b) Aneks Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS).

3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)

Këshilli Profesional i Standardizimit është trup këshillëdhënës, i cili funksionon në kuadër të AKS dhe si i tillë trajton programet e punës, përbërjen dhe drejtimin e komiteteve teknike. KPS gjatë vitit 2022 ka mbajtur dy takime të rregullta pune.


4. Komitetet Teknike (KT)

Komitetet Teknike janë grupe ekspertësh të deleguara nga institucione/organizata/biznese publike ose private, të cilat veprojnë në fusha të caktuara të ekonomisë e që janë të përfshirë në procesin e standardizimit, respektivisht në hartimin dhe adoptimin e standardeve kosovare. KT takohen në bazë të kërkesave nga palët e interesit dhe gjatë vitit 2022 janë mbajtur gjithsejtë 29 takime nga komitete teknike të ndryshme (tabela 1):

- KT për Mjedis (1);
- KT për Energji (2);
- KT për Ndërtim (1);
- KT për Makineri (3);
- KT për Shëndetësi (2);

- KT për Metrologji (1);
- KT për Turizëm (3);
- KT për Përpunim të Drurit (2);
- KT për Miniera dhe Minerale (2);
- KT për Teknologji Informative (1);
- KT për Teknologji Agroushqimore (1);
- KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (2);
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (2);
- KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (4);
- KT për Transport dhe Shërbime Postare (1);
- KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (1).

Tabela 1. Takimet e komiteteve teknike




Gjithashtu është plotësuar/ndryshuar dhe menaxhuar në vazhdimësi lista me bazat deleguese të anëtarëve të të gjitha komiteteve teknike dhe këshillit profesional të standardizimit.

5. Standardet e adoptuara

AKS në vazhdimësi zhvillon standarde të cilat janë me prioritet për ekonominë e vendit, industrinë dhe gjithashtu për plotësim të legjislacionit teknik me theks të veçantë për rregullore teknike të cilat i referohen standardeve. Janë gjithsejtë 502 standarde EN dhe ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare SK gjatë vitit 2022 (tabela 2):

- ✓ KT për Energji (69 SK)
- ✓ KT për Ndërtim (1 SK)
- ✓ KT për Turizëm (20 SK)
- ✓ KT për Makineri (106 SK)
- ✓ KT për Shëndetësi (14 SK)
- ✓ KT për Përpunim të Drurit (39 SK)
- ✓ KT për Miniera dhe Minerale (36 SK)
- ✓ KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (34 SK)
- ✓ KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (61 SK)
- ✓ KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (70 SK)
- ✓ KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (52 SK)

Tabela 2. Standardet e adoptuara SK




6. Standardet e shfuqizuara

Për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike (zyrtarët e AKS) në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet. Standardet mund të rishikohen edhe më shpejt nëse ka kërkesë nga palët e interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale. Në total janë 734 standarde kosovare të cilat janë shfuqizuar gjatë vitit 2022 (tabela 3):

- KT për Ndërtim (130 SK)
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (116 SK)
- KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (33 SK)
- KT për Metrologji (1 SK)
- KT për Shëndetësi (53 SK)
- KT për Energji (98 SK)
- KT për Përpunimin e Drurit (102 SK)
- KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (14 SK)
- KT për Teknologji Agroushqimore (17 SK)
- KT për Miniera dhe Minerale (12 SK)
- KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (46 SK)
- KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (103 SK)
- KT për Teknologji Informative (7 SK)
- KT për Eurokode (2 SK)

Tabela 3. Standardet e shfuqizuara



7. Standardet e shitura

Standardet janë dokumente teknike të cilat zhvillohen në komitete teknike dhe pasi miratohen nga AKS bëhen publike për të gjitha palët e interesit. Çdo kush pastaj mund të blen standarde, e cila bëhet duke identifikuar standardet e duhura dhe duke drejtuar kërkesë në adresën aksinfo@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në zyrat e AKS ose edhe nëpërmjet telefonit 038/512-779, dhe në momentin kur konfirmohet pagesa e faturës, standardi bëhet i gatshëm për blerësin. Në total gjatë vitit 2022, janë shitur 90 standarde kosovare, në vlerën 2,538.00 € për biznese, individë apo institucione. Kryesisht këtë vit, standardet më të kërkuara kanë qenë ato të akreditimit të laboratorëve, produkteve të ndërtimit dhe sistemeve të menaxhimit në përgjithësi.

8. Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit, AKS shkëmben informacion në baza të rregullta me organizatat e standardizimit CEN/CENELEC; ASTM dhe DPS.

9. Notifikimi i standardeve

Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit, AKS është e obliguar të raporton lidhur me standardet e adoptuara dhe të shitura tek organizatat e standardizimit CEN/CENELEC; ASTM dhe DPS. Në këtë kuptim, AKS ka realizuar:

- Notifikimin e standardeve të adoptuara në CEN;
- Notifikimin e standardeve të shitura në CEN;
- Notifikimin e standardeve të adoptuara në CENELEC;
- Notifikimin e standardeve të shitura në CENELEC;
- Notifikimin e standardeve të adoptuara në ASTM;
- Notifikimin e standardeve të shitura në ASTM;
- Notifikimin e standardeve të adoptuara në DPS; dhe
- Notifikimin e standardeve të shitura në DPS.

10. Aktivitetet promovuese të AKS

Promovimi dhe publikimi i secilit standard kosovar, pastaj zhvillimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të AKS dhe rolit e rëndësishëm të standardeve dhe standardizimit në përgjithësi kanë qenë dhe mbeten prioritet i AKS. Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar online në:

<http://www.aks.rks-gov.net> dhe
www.facebook.com/MTI.AKS

Gjatë këtij viti AKS ka publikuar dhe promovuar rolin dhe rëndësinë e standardeve nëpërmjet:

- ❖ Buletineve të Standardeve.
- ❖ Katalogut të Standardeve Kosovare 2022.
- ❖ Materialeve promovuese me logo të AKS.
- ❖ Ditës Botërore të Standardeve.
- ❖ ATV (Emisioni i Mëngjesit - Alarm).
- ❖ Sesionit informativ për studentët e kolegjit UBT.
- ❖ Sesionit informativ për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike/UP.

11. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS

Databaza e Standardeve Kosovare (Sistemi SMIS), siguron porosi online për shitjen e standardeve, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj bizneseve dhe çdo pale tjetër të interesuar për standarde, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve. Gjithashtu kjo databazë, përmes lidhjes me ueb faqe, ofron identifikim më të lehtë të standardeve dhe lexim falas në zyre të AKS nga çdokush që është i interesuar për të lexuar tekstin e standardeve. Sistemi SMIS shfrytëzohet me “user name” nga i gjithë stafi dhe përmban aktivitete si:

- Plotësime të referencave të standardeve.
- Plotësime të “mirrore” të standardeve.
- Krijimi i user name dhe passwordit për palët e interesit.
- Krijimi i linçeve të reja në AKS ueb.
- Ndryshime të strukturës vizuale të AKS ueb.
- Identifikimi i problemeve në SMIS, mos shfaqja e standardeve në ueb të AKS.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk përputhen me çmimet.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk kanë pdf file.
- Futja e të dhënave në data bazë dhe identifikimi i standardeve të dublifikuara.
- Identifikimi i standardeve të shfuqizuara.
- Përpilimi i listave në komitete teknike me standarde të shfuqizuara.
- Përpunimi i fjalorit terminologjik të standardeve.
- Identifikimi i standardeve të harmonizuara.
- Download i standardeve (CEN/CENELEC iProjex).
- Back Up System.

12. Buxheti i AKS

Shpenzimi i buxhetit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit për vitin 2022 është realizuar në shkallë të mjaftueshme. Nga gjithsejtë mallra dhe shërbime prej: 18,992.00 euro, janë shpenzuar rreth 80 %.

13. Grupet punuese/komisionet

Zyrtarët e AKS kanë qenë mjaft të angazhuar nëpër grupe punuese dhe komisione të ndryshme brenda dhe jashtë AKS/MINT si:

- Komisioni për vlerësimin e kërkesave të trupave të vlerësimit të konformitetit për produktet e ndërtimit.
- Komisioni për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit të derivateve të naftës.
- Komisioni për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit për tahografë.
- Komisioni për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit për kontrolle teknike.
- Komisioni për emërim të trupave për vlerësimin e konformitetit për pajisjet nën presion.
- Komisioni për përcaktimin e numrit të përbërësve dhe treguesve të cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës.
- Komisioni për Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve 2023-2025.
- Komisioni për vlerësimin e materialeve promovuese të AKS.
- Komisioni për rekrutim të pozitës: Zyrtar i Bazës së të Dhënave në ARBK.
- Komisioni për rekrutim të pozitës: Zyrtar i Lartë për Standarde në AKS.
- Komisioni për furnizim dhe deponim me vaj ushqimor rezervat shtetërore.
- Komisioni për subvencione/KIESA.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të gatshëm në treg.
- Grupi punues për pajisjen me vula për Agjencinë Kosovare të Standardizimit.
- Grupi Punues Ndërmintor për Kapitullin 1 “Lëvizja e Lirë e Mallrave”.
- Grupi punues me OECD lidhur me Dimensionin e 7 “Standardet dhe rregullat teknike” (Akti për Biznes të Vogël për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2022).
- Grupi punues për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Grupi punues për hartimin e projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.
- Grupi punues për finalizimin e rregullores së brendshme për notifikimin e standardeve në Organizatat Evropiane të Standardizimit (CEN dhe CENELEC).
- Grupi negociator për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian (Single Market Programme-SMP).
- Grupi punues për Rregulloren e pajisjeve të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes (ATEX).
- Grupi punues për Udhëzimin Administrativ për tubat e plastikës.
- Grupi punues për monitorimin e zbatimit të Rregullores 03/2020 për Performancën e Agjencive.
- Grupi punues për rregulloren e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim.

- Grupi punues për rregulloren e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës.
- Grupi punues për hartimin e rregullores për vlerësimin e konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve të besuara të kualifikuara si dhe sigurimi nga rreziku dhe dëmet e shkaktuara nga ofrimi i shërbimit të besuar të kualifikuar.
- Grupi punues për hartimin e Draft-Koncept Dokumentit për fushën e Mbikëqyrjes së Tregut dhe Përputhshmërinë e Produkteve.
- Këshilli Profesional i Akreditimit.

14. Raporte/kërkesa/takime

AKS në vazhdimësi bënë raportim në baza të rregullta (javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore) dhe shqyrtim të kërkesave për të gjitha palët e interesit, si:

- Raport për inputet e KE për Kosovën.
- Raporte për PKZMSA; PRE; PSO; PKZH.
- Raporti vjetor dhe plani i punës për KPS.
- Raporte mujore, tre mujore, gjashtëmujore dhe vjetore për aktivitetet e AKS.
- Raporte mujore dhe pagesa të ndryshme financiare.
- Raport për nën-komitetin e MSA për Tregti Dogana dhe Tatime.
- Raport për planin e veprimit për fushat e pa-harmonizuara.
- Raport për Komitetin VI të Stabilizim-Asociimit.
- Planifikimi i prokurimit AKS 2022.
- Planifikimi i të hyrave vetanake të AKS për 3 vitet e ardhshme (2022-2025).
- Raporte për aktivitetet e standardizimit në dimensionin 7 - OECD.
- Takime me akterë të tjerë dhe palë të interesit.
- Takime të rregullta me stafin e AKS.
- Kalendar i komunikimit të aktiviteteve publike të AKS/MINT.
- Referenca për anëtarët e Këshillit Profesional dhe Komiteteve Teknike.
- Takim me ASHI, për sistemin e-Kosova dhe ndërlidhjen me AKS-SMIS.
- Takimi konsultativ ndërinstitucional me SHERPA.
- Takimi i komponentëve të IC me EFTA Kosova - TBT.
- Përgatitja e Qarkores Buxhetore 2023-2025 dhe Indikatorët e Performances.
- Takim pune me përfaqësues të Projektit “Promoting Private Sector Employment” lidhur me inspektimin, mirëmbajtjen dhe kontrole nga aspekti i sigurisë për pajisjet bartëse të cilat përdoren për qëllime të sporteve zbavitëse - kurset e litarëve.
- Analizë në aspektin e eliminimit të barrierave në tregti (Aneksi 1 dhe 2 i Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti 2022-2025).
- Pyetësori i plotësuar lidhur me AKS (Infrastruktura e Cilësisë-GIZ).

Gjithashtu, AKS ka kontaktuar, shqyrtuar dhe ofruar konsulencë për shumë institucione, kompani dhe biznesi të ndryshme, ku ju është dhënë informacion mbi standardet, zbatimin e tyre, certifikimin, rregulloret teknike të cilat kanë referencë standardet, dhe të tjera sipas kërkesave, si: Sharrcem; Gecert; Agrovat; Kosovo Electricity Distribution Company (KEDS); OAGKS; Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (Ministria e Punëve të Brendshme); Kontrollimi Teknik i Automjeteve; Malësija; Kosova Plast-B; Frashri; Agjencia e Metrologjisë së Kosovës; Alfa I; Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM); StoneCastleWine; I-GPS; Vetoni; Instituti INKOS; Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë; Inspektorati i Energjisë/ME; Oda Hoteliere; Ariani Company; M-TECHNOLOGIE; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; Getest; QSC Inspekt; M&Group; MIFIX; Graniti Holding; RICENS; Eramet; Doganat e Kosovës; Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; Solid Shoes; Departamenti i Industrisë; Model Sllovenia; Ferplan; Kosova-LAB; USAID-Kosovo Compete Activity; Swisscontact; Ozay; Banka Evropiane e Investimeve (EIB); Inspektorati i Tregut; KRU Hidromorava - Gjilan; KRU Bifurkacioni-Ferizaj; Agjencia e Menaxhimit Emergjent; Envision Consulting; Elektro DONI; Laboratori i Mikrobiologjisë SH. A. "Birra Peja"; Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës; IMN Test Beton; Unioni i Turizmit të Kosovës; Qendra Multifunkionale; Mbrojtja e Ambientit; Inter Lab; Graniti; dhe MV Grup; Pro Quality; Galanteria; Zyra Ligjore (KDCA); Roloplast; Kolegji Evropian i Kosovës; etj.

15. Trajnimet

- ✓ Databaza SMIS
- ✓ Microsoft Excel
- ✓ Sjellja organizative
- ✓ Programimi i IPA III
- ✓ Korniza ligjore e AKS
- ✓ Standardizimi në ekonominë qarkore
- ✓ Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit të ideve (GIZ-Gov4SAA)

16. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve të AKS

Korniza ligjore e AKS

Finalizimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim.

Kapacitetet e stafit

Në mënyrë që AKS të njihet si partner në nivelin evropian dhe ndërkombëtar, duhet të ketë staf të mjaftueshëm, të përgatitur dhe të trajnuar mirë, me njohje të gjuhës angleze dhe kompjuterit. Aktualisht AKS ka kapacitete të limituara në këtë drejtim.

Mos anëtarësimi në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare

Në pamundësi për të qenë anëtarë në organizatat evropiane CEN/CENELEC dhe ndërkombëtare të standardizimit ISO/IEC, AKS është e kufizuar në arritjen e vizionit, misionit dhe objektivave të saj.

Databaza SMIS

Digjitalizimi i standardizimit është i pamundur pa aplikimin e një sistemi softuerik të veçantë të standardeve. Data baza aktuale SMIS (Standard Management Information System) është funksionale, mirëpo funksionalizimi i plotë i saj kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme (update + upgrade të sistemit).

Adoptimi i standardeve

Për të ndjekur ritmet e zhvillimit të standardeve nga CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, AKS duhet të adoptoj një numër relativisht të madh të standardeve. Gjithashtu për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike (zyrtarët e AKS) në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet ose edhe më shpejt nëse ka kërkesa nga palët e interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale. Një prej detyrave më të rëndësishme është të fitojmë qasje të plotë në standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe në “meta data”. Sigurimi i qasjes në standardet evropiane tashmë ka filluar duke u bazuar në marrëveshjen licencë me CEN/CENELEC, mirëpo e njëjta duhet të avancohet për shkak të implementimit relativisht të ngadaltë. Për pjesën tjetër të standardeve (ISO, IEC) ne kemi marrëveshje bashkëpunimi me DPS, por akoma jemi pa qasje të drejtpërdrejt në ISO dhe IEC.

Shitja online e standardeve

Është mundësuar vetëm porosia online e standardeve, ndërsa standardet akoma nuk shiten online si pasojë e sistemit elektronik por edhe për arsye të “copy right” (nuk kemi një program për të mbrojtur standardet nga kopjimi). Për të mundësuar plotësisht dhe përmirësuar mënyrën se si përdoruesit e standardeve të blejnë standarde, ne jemi në pritje edhe nga lidhja e databazës SMIS me ASHI (e-Kosova).

Administrimi i komiteteve ekzistuese

Menaxhimi i rreth 130 ekspertëve të angazhuar në 20 KT dhe përfshirja e palëve të interesit në veprimtarinë e standardizimit si dhe trajnimi i tyre mbetet sfidë për AKS.

Përkthimi i “cover page” të standardeve

Standardet e adoptuara, janë kryesisht në gjuhën angleze (me përjashtim të një numri të vogël në shqip), mirëpo përkthimi i standardeve është shumë i shtrenjtë që kërkon buxhet shtesë për përkthim profesional dhe angazhim të madh të stafit të AKS dhe KT.

Eurokodet

Mungesa e buxhetit dhe ekspertëve (profesionistëve të fushave përkatëse), janë ndër faktorët kyç në përgatitjen e anekseve kombëtare për tu kompletuar eurokodet.

Hapësira punese

Janë vetëm dy zyra ku vepron i gjithë stafi i AKS. Këto hapësira punuese janë shumë të vogla dhe si të tilla nuk mundësojnë zhvillimin e takimeve të KPS dhe KT, dhe gjithashtu as të zhvillimit të qendrës së informacionit për standarde “Info Center”. Për tu dëshmuar si të qëndrueshëm dhe të besueshëm, duhet të kemi qendrën tonë funksionale të informacionit, e cila realizon aktivitete të marketingut dhe promovimit dhe që jep udhëzime, informata dhe konsulencë mbi standardet, botimet e reja dhe shfuqizimet, kurse trajnimi, sesione informative, etj.

Promovimi dhe ngritja e vetëdijes për të gjitha palët e interesit

Promovimi dhe publikimi i secilit standard kosovar, pastaj zhvillimi i mëtejshmë i politikave dhe programeve të AKS, publikimi i materialeve promovuese (katalog, buletinë, fletushka, etj.); dhe roli e rëndësia e standardeve dhe standardizimit në përgjithësi kanë qenë dhe mbeten prioritet i AKS. Këtu sfidë është edhe rritja e bashkëpunimit me ministrinë e linjës, institucionet dhe organizatat të cilat i referohen standardeve.

Faktorë të jashtëm

- Mungesë e zhvillimit të industrisë dhe ekonomisë.
- Mungesë e buxhetit dhe mekanizmave shtetëror për mbështetje të bizneseve.
- Mungesë e bizneseve të mëdha.
- Mungesë e bizneseve prodhuese.
- Mungesë e bizneseve eksportuese.
- Mungesë e ekspertëve në fushën e standardizimit.

17. Sfidat e standardizimit kosovar

- Përkthimi i standardeve.
- Funkcionalizimi i plotë (update + upgrade) i SMIS.
- Anëtarësimet në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare.
- Zhvillimi i një qendre të informacionit për standarde (Info Center).
- Interesimi i ultë i pjesëmarrjes në procesin e standardizimit.